



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr.8782/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 neni 30, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 52, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2024 merr:

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2025 PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR NPL "PASTRIMI" SH.A HANI I ELEZIT**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e biznesit për vitin 2025 për Ndërmarrjen Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave N.P.L "PASTRIMI" SH.A Hani i Elezit.
2. Plani i biznesit për vitin 2025 për Ndërmarrjen Publike Lokale përmban gjithsej 20 (njëzet) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- N.P.L Pastrimi SH.A,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 31.10.2024





Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008) neni 40.2 (b), Ligji Nr.03/L-48 – për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/03 Qershor 2008), Ligji Nr.03/L-221- për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048-për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/03 Gusht 2016), Ligji Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.26/29 Dhjetor 2023) neni 15, 16, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 65, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2024 merr:

### VENDIM

#### PËR HARMONIZIMI –TRANSFERI I MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË BUXHETORE PAGA DHE SHTESA

1. Miratohet kërkesa me numër 04/8564/2024 për Harmonizimi-Transferi i mjeteve buxhetore në kategorinë buxhetore Paga dhe Shtesa.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi transferet e mjeteve financiare do të bëhen:

#### **Transferet e mjeteve nga kategoria e Pagave dhe Shtesa (fondi 10):**

##### **Nga Nën-Programet:**

- Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111), shuma prej 739.00 €,
- Zyra komunale për Komunitete (19675), kodi funksional (1090), shuma prej 6,633.85 €,
- Pylltaria dhe Inspeksioni (47115), kodi funksional (0422), shuma prej 20,522.42 €,
- Turizmi (48075), kodi funksional (0473), shuma prej 48.30 €,
- Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), shuma prej 342.71 €,
- Administrata (43044), kodi funksional (73044), shuma prej 7,659.61 €,
- Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 18,000.00 €,
- Arsimi Parashkollor (92890), kodi funksional (0911), në shumë prej 9,000.00 €,
- Arsimi i Mesëm i Lartë, (95220), kodi funksional (0922), shuma prej 15,500.00 €.

##### **Në Nën-Programet:**

- Administrata dhe Personel (16335), kodi funksional (0133), në shumë prej 3,575.78 €,
- Zyra e Kuvendit Komunal (16935), kodi funksional (0111), në shumë prej 22,317.77 €,
- Buxhetimi (17535), kodi funksional (0112), në shumë prej 2,527.14 €,
- Parandalimi dhe Inspektimi (18444), kodi funksional (0320), shuma prej 1,561.56€,
- Shërbime Sociale (75671), kodi funksional (1040), shuma prej 19.86 €,
- Administrata e Arsimit (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 10.41 €.
- Arsimi Fillor, i mesëm i ulët (94020), kodi funksional (0912), shuma prej 48,433.37 €.

**Transferet e mjeteve nga kategoria e Investimeve kapitale (fondi 10):**

**Në kuadër të nën-programit Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve (18444), kodi funksional (0320).**

**Transferohet nga projekti:**

“Ndërtimi (ngritja e deponisë) për mbetje të ngurta (inerte), kodi (55036) në shumë prej 10,000.00 €, **fondi burimor (10)** .

**Transferohet në:**

- Arsimi Fillor, i mesëm i ulët (94020), kodi funksional (0912), kategoria buxhetore Paga dhe Shtesa, shuma prej 10,000.00 €,

**Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).**

**Transferohet nga projekti:**

- “Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava- Shpronësim” kodi (53902) **fondi (10)**, shuma prej 19,177.65 €, **fondi burimor (10)**.

**Transferohet në:**

- Arsimi Fillor, i mesëm i ulët (94020), kodi funksional (0912), kategoria buxhetore Paga dhe Shtesa shuma prej 19,177.65 €,
- **Në kuadër të nën-programit Administrata – Hani i Elezit (92175), kodi funksional (0980).**

**Transferohen nga projektet:**

- “Pajisja me gjenerator në Qendrën Kulturore “Imri Curri” (54722), në shumë prej 5,000.00 € nga **fondi burimor (10)**.
- “Restaurimi i objekteve me trashëgimi kulturore te bunkerat në Parkun Isa Berisha dhe në shkollën fillore të fshatit Krivenik” (54696), në shumë prej 10,000.00 €, **fondi burimor (10)**.

**Transferohet në:**

- Arsimi Fillor, i mesëm i ulët (94020), kodi funksional (0912), kategoria buxhetore Paga dhe Shtesa shuma prej 15,000.00 €.

**Transferet e mjeteve nga kategoria e Investimeve kapitale (fondi 21):**

**Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).**

**Transferohet nga projekti:**

- “Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava- Shpronësim” kodi (53902) **fondi (21)**, shuma prej 15,000.00 €, **fondi burimor (21)**.

**Transferohet në:**

- Arsimi Fillor, i mesëm i ulët (94020), kodi funksional (0912), kategoria buxhetore Paga dhe Shtesa shuma prej 15,000.00 €.

3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 31.10.2024

